

**Bizneset e vogla
përpunuese nisin të
shfrytëzojnë mediat sociale
për të rritur praninë në treg**

FAQE 2

**Transformimi i jetesës me
veprime gjithëpërfshirëse**

FAQE 3

**Ndërmarrësi nga
Kosova sjell në treg
produkte nga frutat arrore**

FAQE 4

2021
QERSHOR

BULETINI.

PROMOVIMI I
PUNËSIMIT NË
SEKTORIN PRIVAT



Udhëtimi i sigurt dhe kohërat më të mira

Në përpjekje për të kthyer besimin në udhëtim në mes të pandemisë, Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit WTTC ka prezantuar Protokollet dhe Vulën Safe Travels. Vula iu lejon udhëtarëve të njohin ofruesit e shërbimeve të turizmit që implementojnë protokollet e duhura të shëndetit dhe higjienës dhe të ndihen të sigurt kur udhëtojnë. Ajo bazohet në vetëvlerësim dhe ofruesit e akomodimit dhe të destinacioneve turistike përdorin protokollet, termat dhe kushtet e nevojshme, duke synuar sigurinë për vizitorët e tyre.

Në përgjigje të nevojës për t'u përshtatur me praktikën që do të siguronin më së miri qëndrueshmëri në standardet e sigurisë, projekti Promovimi i Punësimit të Sektorit Privat (PPSE) mbështetoi sektorin e turizmit përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe organizimit të punëtorëve. Projekti ofroi mbështetje teknike për Unionin e sapo themeluar të Turizmit në Kosovë, përmes ndërtimit të kapaciteteve për sigurimin e Protokolleve dhe Vulës Safe Travels për sektorin privat dhe

punëtorin për sektorin e mikpritjes. Këto aktivitete u organizuan në mënyrë që të informonin sektorin për trendet globale të COVID-19 dhe protokolleve më efektive të rimëkëmbjes së WTTC, si dhe masat e duhura që duhet zbatuar për të marrë vulën Safe Travels.

Suksesi i vulës së Safe Travels tërhoqi vëmendjen e Komunitetit të Pejës menjëherë. Derisa qyteti po përgatitej të hapte dyert për turizmin dhe të mirëpriste përsëri vizitorët në qytet, ata bashkuan përpjekjet e tyre me projektin PPSE për të rifilluar punën në industri pas pandemisë dhe për të rindërtuar besimin tek turistët. Peja është destinacion i rëndësishëm turistik në Kosovë, i njohur dhe i vizituar shpesh nga vizitorë vendas dhe ndërkombëtarë. Historia, kultura, tradita, tokat dhe burimet natyrore e bëjnë atë një qendër turistike. Prandaj, ndërhyrja u krijua paralelisht me përpjekjet e Pejës për të rimëkëmbur industrinë e saj vitale të turizmit. Në fillim, ekspertët vendorë të turizmit u angazhuan në procesin e identifikimit të

NVM-ve të mundshme të turizmit dhe subjekteve të interesuara në zbatimin e masave të shëndetit dhe sigurisë, të sugjeruara në protokollet WTTC. Ky proces u krye përmes një pune të gjerë në terren dhe vizitave që rezultuan në identifikimin e 26 SME-ve të turizmit dhe njësisve përkatëse. Sesionet e trajnimit u organizuan për secilin nën-sektor të turizmit dhe pjesëmarrësit u trajnuan në hollësi mbi masat e shëndetit dhe sigurisë të përfshira në protokollet përkatëse.

Deri më tani, në të gjithë Kosovën, 37 NVM të turizmit kanë përfunduar trajnimin dhe 18 prej tyre tashmë kanë marrë vulën Safe Travels, nga të cilat 4 janë në Pejë. Deri në fund të korrikut 2021, 10 biznese të tjera në Pejë pritet të marrin vulën, së bashku me 11 subjekte të tjera në të gjithë Kosovën.

Suksesi i këtij aktiviteti nuk është i rëndësishëm vetëm për vendet dhe destinacionet, por edhe për njerëzit që punojnë dhe varen nga sektorët e udhëtimit dhe turizmit.

INFORMATAT KRYESORE NGA PUNA JONË

Bizneset e vogla përpunuese nisin të shfrytëzojnë mediat sociale për të rritur praninë në treg

■ Bizneset e vogla, si përpunues të ushqimit, artizanë, pronarë të bujtinave apo të fermave më të vogla përballen me sfida të ndryshme drejt arritjes së suksesit me bizneset e tyre të reja, apo që t'i rrisin më tej bizneset ekzistuese. Këto sfida u bënë më të vështira për t'u përballuar si rezultat i pandemisë së COVID-19, që ua shtoi ngarkesën sa i përket pjesëmarrjes së tyre direkte në treg.

Për t'i përkrahur këto biznese të vogla, kryesisht përpunues të ushqimit, në vitin 2021 PPSE nisi intervenimin "Kanalet digjitale të shitjes për përpunuesit e vegjël", me fokus tek bizneset në pronësi të grave. Ky intervenim synon t'i mbështesë bizneset e reja që janë duke hyrë në tregun e përpunimit të ushqimit, apo bizneset më të vogla që kërkojnë të zgjerohen, për t'i shtyrë përpara përpjekjet e tyre nëpërmjet qasjes dhe vizibilitetit të shtuar online.

Bizneset pjesëmarrëse fillimisht u trajnuan për tema si: çfarë janë shitjet online dhe përfitimet nga kjo, si të përdoret media sociale për biznes, me theks tek Facebook dhe Instagram, familjarizimi me uebfaqet dhe platformat e shitjes online, këshilla për përmbajtjen, marketinguin përmes emailit dhe influencuesve. Më pas, secilit biznes iu ofrua përkrahje e përshtatur sipas llojit të nevojave të atij biznesi.

Deri më tani, 19 biznese kanë ndjekur trajnimin dhe kanë përfituar nga përkrahja nëpërmjet këtij intervenimi. Pronarët e bizneseve janë pajisur me shkathësitë e nevojshme për të nisur aktivitetin online, për të nxjerrë më të mirën nga mjetet digjitale dhe mediat sociale që të përmirësojnë vizibilitetin e tyre dhe për t'i diversifikuar kanalet e shitjes.

Një rast i tillë është Resmija Sylejmani, nga Suhodolli në Mitrovicë. Resmija dikur ka punuar për një kompani më të madhe të përpunimit të ushqimit. Në fillim të vitit 2021



ajo hapi biznesin e saj, 'Shporta e Traditës'.

Ajo ka shkathësi dhe përvojë në përpunimin e perimeve dhe frutave, ndaj lista e produkteve të Resmijes përfshin receta tradicionale për ajvar, pestil nga kumbullat dhe specia turshi. Për momentin, Resmija merret vetë me prodhimin dhe herë pas here e ndihmojnë pjesëtarët e familjes. Sapo biznesi të marrë veten, ajo do të punësojë gra të tjera nga banorët e zonës që ta ndihmojnë.

Në kuadër të aktiviteteteve të intervenimit, Resmija ka hapur një faqe në Facebook për biznesin e saj të sapothemeluar, ka mësuar si të bëjë foto të produkteve, si të shkruajë përshkrimet e produkteve për mediat sociale dhe si ta ndërtojë brendin online hap pas hapi.

Rezultati i kombinuar i punës së bërë me të gjitha këto biznese krijon një mjedis online ku bizneset e vogla mund të avancojnë më tej, të bëhen pjesë e një komuniteti më të zgjeruar online dhe të kontribuojnë për një ekonomi gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme digjitale, që funksionon për të gjithë.





Transformimi i jetesës me veprime gjithëpërfshirëse

Për shumë pjesëtarë të komunitetit rom që jetojnë në zonat rurale në Kosovë, bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave dhe punësimi. Kryesisht pronarë të fermave të vogla, ata përballen me pengesa si mungesa e qasjes në burime për t'u zgjeruar më tej dhe e inpleteve për t'i diversifikuar kulturat që mbjellin, por edhe për të patur qasje në tregje më të mëdha.

Ismailj Butiq, ish-saldator tani fermer nga fshati Livagje në Graçanicë, dhe familja e tij, janë ndër të paktët romë që jetojnë në këtë fshat. Që nga viti 2000, Ismailji dhe familja e tij 13-anëtarëshe: bashkëshortja, dy djemte me bashkëshortet e tyre dhe fëmijët, e nxjerrin jetesën duke u marrë me bujqësi në tokën e tyre 0.5 hektarë. Prodhimin kryesisht e përdorin për nevojat e tyre dhe sasi më të vogla i shesin në dyqanet apo tregjet aty pranë. Ata mbjellin kryesisht kultura tradicionale: fasule, qepë, hudhra, domate, patate dhe specia.

“Nuk përdorim kurrë pesticide. Është e rëndësishme ta dimë se ushqimi që hamë është i shëndetshëm” thotë Ismailji, i cili përveç tokës që e ka pronë, merr me qira edhe rreth 3 hektarë, gjithashtu të patrajtuar me pesticide. Kjo ka bërë të mundur që ai të orientohet në një drejtim tjetër për ta zgjeruar aktivitetin e tij si fermer: kultivimi i bimëve aromatike mjekësore (BMA). Ai tashmë ka mbjellë hithra, mentë, luledielli dhe kalendulë.

Kjo mundësi e re u krijua nëpërmjet bashkëpunimit me kompaninë Agroproduct, një nga qendrat më të mëdha grumbulluese për bimë mjekësore aromatike në Kosovë. Bashkëpunimi

ndërmjet qendrës grumbulluese dhe fermerit përcjell modelin e bujqësisë së kontraktuar që në Kosovë e ka prezantuar projekti Promovimi i Punësimi në Sektorin Privat (PPSE) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Sipas këtij modeli, Agroproduct i siguron Ismailjit fidanet, pa pagesë, dhe ia siguron tregun për të gjithë produktin.

PPSE ka angazhuar dhe një agronome për ta ndihmuar Ismailjin me këshilla për kultivimin e BMA-ve dhe për ta monitoruar të gjithë procesin. Po ashtu, PPSE e ka mbështetur Ismailjin të blejë një makinë tharëse, që është dhe hapi i tij i parë drejt shndërrimit në një qendër grumbulluese, me fjalë të tjera, për të angazhuar familje të tjera në fshat që të nisin kultivimin e BMAve, duke krijuar kështu mundësi të reja për ta.

Ismailji është fermeri i parë nga komuniteti rom në këtë zonë që është bërë pjesë e aktivitetit të bujqësisë së kontraktuar për BMA për komunitetet pakicë. Si një intervenim pilot në bujqësinë e kontraktuar për BMA, qëllimi është që të zhvillohet dhe zgjerohet në zona të tjera. Ndaj, përfshirja e fermerëve të tjerë romë në këtë aktivitet varet nga suksesi i Ismailjit dhe ai e di këtë mirë.

“Unë jam fermeri i parë në këtë zonë që kultivon BMA, Mirëpo, nuk përfitoj vetëm unë. Unë po sjell një model që do të krijojë mundësi për banorët e tjerë të fshatit, të cilët janë të gjithë të papunësuar. Modeli i bujqësisë së kontraktuar është mundësi për një jetë të re” thotë ai.



A E KENI DITUR SE...?

A

...Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbështet nxitjen e ndërmarrësisë edhe nëpërmjet ekspertizës së seniorëve? Profesionistët e pensionuar të Kontaktit të Ekspertëve Seniorë (SEC) vullnetarisht ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre për biznese të vogla dhe të mesme që kanë nevojë për konsulentë, por që nuk mund ta përballojnë pagesën për konsulentë. Qëllimi është të rritet konkurrueshmëria e tyre, të përkrahjet zhvillimi i tyre i qëndrueshëm dhe të krijohen vende pune. Në vitin 2021, tetë biznese nga Kosova: prodhues i sapunit të lëngshëm dhe detergjentëve, çajit organik, ëmbëlsirave dhe tortave, produkteve të kozmetikës natyrale ose gjalpët nga frutat arrore kanë përfitur nga kjo përkrahje. Rritja e efikasitetit, përmirësimi i cilësisë së produktit, projekte inovative ishin fjalët kyçe të përkrahjes së ofruar. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, përkrahja u ofrua nga distanca, duke i shtyrë kështu edhe bizneset, edhe ekspertët, drejt eksplorimit të mënyrave të reja të bashkëpunimit.

B

...janë 7 Via Ferrata në Kosovë, që e bëjnë vendin një destinacion unik dhe të parin në Ballkan që ka zhvilluar rrugë të hekurta? Mund të gjeni 4 prej tyre në Pejë: Marimangat, Mat, Ari dhe Shpellat, Panorama në Prizren, Shpellat Binjake në Istog, Berim në Zubin Potok dhe Via Ferrata Deçani. Këto Via Ferrata janë ndërtuar të gjitha me mbështetjen e institucioneve publike lokale, entuziastëve të turizmit dhe organizatave të tjera në partneritet me PPSE Swisscontact. Më e gjata është Marimangat në Pejë me gjatësi prej 1 km dhe më e shkurtra është Shpella Binjake në Istog, e gjatë vetëm 50 metra.

C

...certifikimi organik në bletari mbron mirëqenien e bletëve, njerëzve dhe të mjedisit? Partneri ynë, Shoqata ORGANIKA ka mbajtur një seri me trajnime në sallë për pesë grupe të grave bletare në kuadër të punës së tyre për të konsoliduar bletarinë organike në Kosovë. Programi është një përzjerje e trajnimit në sallë dhe online, për ta zgjeruar përvojën e të nxënësve dhe rrjetëzimin. Pjesëmarrëset mësuuan rreth kërkesave dhe procedurave për bletari organike që çojnë drejt marrjes së certifikatës organike.

D

...turizmi konsiderohet si një nga përgjigjet kryesore strategjike ndaj rimëkëmbjes ekonomike post-pandemike në të gjithë botën? Përveç potencialit për të shërbyer si mjet zhvillimi, krijon gjithashtu vende pune dhe siguron të ardhura për gratë dhe të rinjtë. Sidoqoftë, kjo pengohet kur ka mungesë të një strategjie të qartë turistike, prandaj, PPSE Swisscontact ka facilituar hartimin e një Strategjie të re Kombëtare të Turizmit të Kosovës. Në një proces më gjithëpërfshirës, diskutimi për zhvillimin e turizmit ka sjellur së bashku akterët e turizmit, institucionet qeveritare, komunitetet e destinacioneve dhe ekspertë. Strategjia do të identifikojë vizionin dhe drejtimin e zhvillimit të turizmit dhe do të përcaktojë përparësitë kryesore të zbatimit të këtij vizioni afatgjatë.

MODELI PËR NDRYSHIM

Ndërmarrësi nga Kosova sjell në treg produkte nga frutat arnore

Dyqani i këndshëm i 'Pelini's' në Prishtinë sjell një listë të pasur të produkteve të shijshme dhe të shëndetshme: lloje të ndryshme të frutave arnore, gjalë të freskët nga këto fruta arnore që prodhohet në çast, vaj arror me shtypje të ftohtë, fruta të thata, lloje të miellit, që të gjithë këto përbërës janë gjithnjë e më shumë pjesë e dietës së jetesës së shëndetshme.

Gjatë zgjerimit dhe avancimit të aktivitetit të tij prodhues, Ervini arriti në një fazë kur i nevojitej përkrahje, një shtysë më shumë. Në kuadër të bashkëpunimit me projektin Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, 'Pelini's' bëri disa ndryshime.

Së pari, u mundësua blerja e linjës për prodhimin e gjalpëve nga frutat arnore, vajit të kokosit dhe prodhimin të tahin-hallvës. Krahas me këtë linjë, u përmirësua teknika e prodhimit, efikasiteti, si dhe u rrit kapaciteti, gjë që mundëson shtrirje më të madhe në treg. Dizajni i uebfaqes dhe i paketimit për produktet e reja ishte po ashtu pjesë e kësaj përkrahjeje.

Përkrahja u zgjerua më tej me përmes konsulencës së ofruar nga shërbimi Kontakti i Ekspertëve Seniorë të organizatës Swisscontact. Kompania ka shtuar numrin e produkteve dhe e




ka përmirësuar formulën e tyre, është rritur efikasiteti i cilësisë së punës dhe kapaciteti.

Shitorja 'Pelini's' është një nga hapësirat interesante të Prishtinës, ku konsumatorët jo vetëm furnizohen me lajthi të cilësisë së lartë, të prodhuara në Kosovë, por mund të blejnë edhe gjalpëra nga frutat arnore që prodhohen aty për aty.

"Kemi shumë klientë që blejnë tek ne jo vetëm për nevojat e tyre, por edhe dhuratat. Ata vijnë me kavanozët e tyre të qelqit për t'i mbushur me çfarëdo gjalpi apo produkti tjetër që u shijon. Kjo mënyrë e paketimit dhe e ripërdorimit të kavanozëve të qelqit është në përputhje me filozofinë tonë mjedisore" tregon Ervini.

Lexoni më shumë këtu: <https://bit.ly/3gTf-NB2>



Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383(0)38220403
email: ppseinfo@swisscontact.org
website: www.ppse-kosovo.org and
www.swisscontact.org/kosovo
www.facebook.com/ppse.kosovo
https://twitter.com/PPSE_Kosovo
<https://www.instagram.com/ppsekosovo/>

PROMOVIMI I PUNËSIMIT NË SEKTORIN PRIVAT

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.